



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 5960/Prot.
1

Tiranë, më 01.12.2023

Lënda: Kthim përgjigje,

Z. Sokol Mëngjesi

Ad: Blv. "Bajram Curri", Pall. "Agimi", Shk. 4, Ap. 64 (7)

TIRANË

Në përgjigje tuajës datë 13.11.2023, protokolluar me tonën nr. 5960 Prot, datë 15.11.2023, me anë të së cilës kërkonti vënie në dispozicion të dokumentacionit dhe historikut në lidhje me procedimin disiplinor ndaj gjyqtares znj. Irena Gjoka (Maneku), në vitin 1996 (duke përfshirë kërkesën për iniciimin e procedimit, raportin mbi hetimet që janë kryer, vendimet etj), sa më poshtë sqarojmë:

Në lidhje me periudhën për të cilën kërkonti informacion dhe dokumentacion, organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ishte i ndryshëm nga KLD e krijuar me Kushtetutën e vitit 1998 dhe ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001.

Organizimi i mbledhjeve plenare në ato vite, zhvillohej në institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë apo dhe në Ministrinë e Drejtësisë, institucione këto të cilat përgatisnin dokumentacionin që shqyrtohej në të, për rrjedhojë dhe vendimet përkatëse.

Gjithashtu, sqarojmë se, për periudhën që ju kërkonti informacion dhe dokumentacion, më konkretisht për vitin 1996, për znj. Irena Maneku, emëruar me Vendimin nr. 14, datë 21.12.1993, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjyqtare pranë Gjykatës Fier, bazuar në Regjistrin Themeltar të Ministrisë së Drejtësisë, që disponon Këshilli i Lartë Gjyqësor, rezulton se:

1. Me Vendimin nr. 7, datë 08.02.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, znj. Irena Maneku, është liruar nga detyra për shkak të paaftësisë në kryerjen e detyrës,
2. Me Vendimin nr. 8, datë 23.08.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, znj. Irena Maneku, është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës Mallakastër.

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

RUDIN BAQLI

